



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 18, datë 31.03.2022

**PËR**  
**NGRITJEN E SHËRBIMEVE ME BAZË KOMUNITARE PRANË QENDRËS**  
**KOMUNITARE MULTIFUNKSIONALE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE**  
**RRASHBULL, DURRËS**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, ligjit nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Deklaratën e Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, ligji nr.121/2016, “Për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr.658, datë 17.10.2005 “Për Standartet e Shërbimeve Shoqërore”, Udhëzimin nr. 911, datë 27.12.2018 “Për miratimin e Standarteve të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Qendrat Komunitare Shumëdisiplinore”, VKB-së Nr. 158, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022, si dhe projektbuxhetin afatmesëm 2022-2024”, Marrëveshjes së bashkëpunimit me Fondacionin Terre des Hommes nr. 6006 prot., datë 18.05.2021, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ngritjes së shërbimeve me bazë komunitare pranë Qendrës Komunitare Multifunksionale në Njësinë Administrative Rrashbull, Durrës.

2. Miratimin e përdorimit të fondit prej 1.350.504 lekë miratuar me VKB-në 158, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022, si dhe projektbuxhetin afatmesëm 2022-2024” për drejtuesin e qendrës dhe punonjësin social, i cili do të kryejë funksionet e Njesisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave për Njësinë Administrative Rrashbull.
3. Veprimet financiare të kësaj qendre do të kryhen nga nëpunësi zbatues i nivelit të dytë pranë Qendrës Ditore të të Moshuarve.
4. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Shërbimit Social, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Qendra Ditore e të Moshuarve, Bashkia Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 31.03.2022**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 281 / prot.  
2

Durrës, më 05.04.2022

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓  
Durrës

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.18 datë 31.03.2022 “Për ngritjen e shërbimeve me bazë komunitare pranë qendrës komunitare multifunkionale në Njësinë Administrative Rrashbull, Durrës.”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

